



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 635/1 Prot.

Tiranë, më 25 / 04 / 2019

V E N D I M

Nr. 56, Datë 25 / 04 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 13, datë 12.02.2019, të paraqitur nga Y.B¹ kundër Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike²”. Në formularin e ankesës nuk identifikohet, Ministria e Brendshme si subjekt që pretendohet të ketë kryer diskriminim, por me kërkesën³ e ankuesit u pa e arsyeshme të kërkohej informacion nga ky institucion, pasi është përgjegjës për trajtimin e kërkesave të shtetasve të huaj, azilkërkues apo refugjatë në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi informon se: *“Që në vitin 2016 ka ardhur në Shqipëri si azilkërkues dhe është akomoduar në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues në Babrru, Tiranë. Nga data 06.12.2016 është pajisur me leje qëndrimi për të huajt (provizore) me nr. 103911 të vlefshme për periudhën: 06.12.2016 deri në datë 05.02.2017 dhe më vonë është pajisur me leje qëndrimi për të huajt, Tipi A, të vlefshme për periudhën: 06.12.2016 deri më datë 06.12.2017. Ankuesi informon se mospasja e lejes së qëndrimit nuk i krijon mundësinë për të punuar dhe për të krijuar të ardhura për të jetuar jashtë mjediseve të QKPA. Ankuesi pretendon se po diskriminohet nga ana e Ministrisë së Brendshme pasi nuk po pajiset me leje qëndrimi dhe më pas me dokument identifikimi Shqiptar për shkak të bindjes së tij politike, ndërkohë që azilkërkues të tjerë nga Ukraina dhe shtete të tjera që janë të akomoduar në QKPA, janë pajisur me leje qëndrimi dhe dokument identifikimi Shqiptar”.*

¹ Y.B ka lindur në Kharkiv Oblast, Ukrainë.

² Y.B informon se ka qenë aktivist i partisë “Lëvizja Popullore e Ukrainës” (Narodnyi Rukh Ukrainy).

³ Referuar shpjegimeve të ankuesit të mbajtur në procesverbalin datë 19.02.2019 në mjediset e KMD-s.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe pajisjen me leje qëndrimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr.13, datë 12.02.2019 të shtetasit Y.B u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 227/1, datë 20.02.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Ministria e Brendshme, lidhur me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga Y.B.

Me shkresën nr. 121/2, datë 26.02.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues (QKPA), në mes të tjerash informon se: *“Shtetasi Y.B është akomoduar në QKPA në datë 30.10.2016. Ai është pajisur me Leje Qëndrimi për të Huajt në datën 06.12.2016 e cila ka qenë e vlefshme deri me datë 05.02.2017, ku motivi i qëndrimit është, Mbrojtje Humanitare. Në datën 08.05.2017 këtij azilkërkuesi i është rinovuar Leja e Qëndrimit për të Huajt e vlefshme deri më datë 06.12.2017.*

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjatë qëndrimit në QKPA, azilkërkuesi i lartëpërmendur ka rezultuar problematik në sjelljen e tij ndaj punonjësve të administratës duke u treguar i papërmbajtshëm dhe sulmuar verbalisht me shprehje në gjuhën angleze dhe ruse. Duke u nisur nga sjellja e tij, me datë 22.05.2017, azilkërkuesi është dërguar për vizitë pranë Qendrës Komunitare të Shëndetit Mendor (QKSHM) Nr.3, i shoqëruar nga punonjësit e Sektorit të Mbështetjes së Azilkërkuesve (SMA) dhe përkthyesi i gjyhës ruse. Në bazë të refertit “Përgjigje-Rekomandim” të lëshuar nga mjekja specialiste psikiatre, A.A, azilkërkuesi rezultoi me diagnozën: “Sindroma psikotike për t’u determinuar”. Për rrjellojë, mjekja specialiste përshkroi recetën me medikamente që azilkërkuesi duhet të merrte. Receta u ekzekutua nga ana e qendrës në bazë të procedurave të brendshme, por Y.B ka refuzuar t’i marrë ato. Psikologjia e qendrës është përpjekur të zhvillojë seanca psikologjike me Y.B në prani dhe të përkthyeses së gjuhës ruse me qëllim bindjen e tij për marrjen e medikamenteve të përshkruara nga mjeku, ku pavarësisht përpjekjeve ai ka refuzuar t’i marrë ato”.

- Me shkresën nr. 227/3, datë 20.03.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar dhe njëherë nga Ministria e Brendshme, informacion lidhur me pretendimet për diskriminim të shtetasit Y.B.

Me shkresën nr. 1502/2, datë 04.04.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme, informoi se ka kthyer përgjigje mbi trajtimin dhe gjendjen shëndetësore të shtetasit Y.B, nëpërmjet stukturës së saj QKPA, në datë 26.02.2019.

- Me shkresën nr. 227/5, datë 11.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar përsëri nga Ministria e Brendshme, informacion lidhur me arsyet e mospajisjes me leje qëndrimi të shtetasit Y.B që prej datës 07.12.2017 si dhe numrin e shtetasve Ukrainas nga krahina e Krimesë të cilët kanë përfutuar leje qëndrimi në Shqipëri.
- Me shkresën nr. 567, datë 11.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga QKPA, informacion lidhur me numrin e shtetasve Ukrainas të cilët kanë qenë apo janë të akomoduar në QKPA.

Me shkresën nr. 253/1, datë 16.04.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, QKPA informoi se: *“Gjatë periudhës 01.12.2016-11.04.2019 në QKPA është akomoduar një shtetase me origjinë nga Ukraina e cila është larguar vullnetarisht në datën 03.08.2018. Shtetasi nga Ukraina Y.B është akomoduar në QKPA në datën 30.10.2016 dhe është larguar në datën 10.04.2019. QKPA është një qendër e hapur dhe nuk disponojnë asnjë informacion në lidhje me këta persona, të cilët janë larguar në mënyrë vullnetare”.*

Me shkresën nr. 1502/4, datë 23.04.2019, të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministria e Brendshme, informoi se: *“Bazuar në ligjin nr.108/2013 “Për të huajt”, neni 34, “Lëshimi i lejes së qëndrimit”, dokumentacioni i kërkuar trajtohet dhe lëshohet nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit, në qytetin ku ndodhet i huaji. Shtetasi në fjalë, është larguar nga QKPA, më datë 10.04.2019, me vullnetin e tij të lirë, duke mos njoftuar arsyet dhe destinacionin”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Procedura për dhënien dhe heqjen e azilit për personat e huaj apo pa shtetësi parashikohet në ligjin nr. 121, datë 18.09.2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”. Kështu, në nenin 4 “E drejta për azil” parashikohet se: *“Në R.SH garantohet e drejta për azil e të huajit apo personit pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit fetar, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, si pasojë e këtyre ngjarjeve, për arsye të kësaj frike”.*

Ligji Nr. 121, datë 18.09.2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7/1 dhe 2 “Autoritetet përgjegjëse”, parashikon se: 1. *“Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët”* dhe 2. *“Autoriteti kompetent në kufi për trajtimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare është struktura përgjegjëse për kufirin dhe migracionin”,* ndërsa në nenin 21, “Kompetencat e autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët”, parashikohet se: *“Autoriteti i vetëm për dhënien, heqjen dhe përjashtimin nga e drejta për azil dhe mbrojtje ndërkombëtare është struktura pranë ministrisë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët. Ajo është përgjegjëse për trajtimin e aplikimeve, procedimin, shqyrtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se autoriteti përgjegjës për të kthyer përgjigje lidhur me pretendimet e ankuesit Y.B është Ministria e Brendshme.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikon se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të

gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri vlerëson se, Ministria e Brendshme dhe QKPA kanë dërguar shkresat: nr. 121/2, datë 26.02.2019, nr. 1502/2, datë 04.04.2019 dhe nr. 253/1, datë 16.04.2019, të cilat në pamje të parë duket sikur përmbushin detyrimin për të dhënë informacion në lidhje me ankesën, por në thelb nuk i shërbejnë hetimit administrativ të filluar nga Komisioneri, me qëllim marrjen e një vendimi për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë i qartë dhe i drejtpërdrejtë në kërkesat e tij, në mënyrë që të mund të realizonte një hetim të paanshëm, objektiv dhe të arsyetuar lidhur me verifikimin dhe provimin e pretendimit të ankuesit.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe informacion mbi mospajisjen me leje qëndrimi të shtetasit Y.B pas datës 06.12.2017 dhe trajtimit të barabartë me azilkërkues të tjerë, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte një bazë krahasimore dhe të shqyrtonte këtë ankesë me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri konstaton se Ministria e Brendshme me dijeninë e plotë nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar mbi shkaqet e mospajisjes së shtetasit Y.B dhe krahasimit me persona të tjerë, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e njëanshëm, të pafavorshëm apo jo të ankuesit krahasuar me shtetas të tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme.

Mungesa e dhënies së informacionit, ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e shqyrtimit të çështjes dhe marrjen e një vendimi brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, rezulton e provuar se Ministria e Brendshme, ka shkelur nenin neni 32, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 32/2: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*, si dhe neni 33/13: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”: b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;*

Në lidhje me interesimin e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se ankuesi pas dorëzimit të ankesës nuk ka shfaqur interesim për të ndihmuar me informacion shtesë, pasi është larguar nga QKPA dhe nuk ka adresë apo numër telefoni me të cilin të kontaktohet lidhur me shqyrtimin e ankesës së tij.

Për sa më sipër, në mungesë të informacionit zyrtar nga ana e Ministrisë së Brendshme në lidhje me mospajisjen me leje qëndrimi të shtetasit Y.B pas datës 06.12.2017 dhe moskontaktimit të subjektit ankues, për shkak se është larguar nga mjediset akomoduese dhe nuk ka mundësi komunikimi me të, në mbështetje të nenit 95, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilën parashikohet: *Pamundësia në objekt apo qëllim: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi pushimin e shqyrtimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nenin 1, pika 3, neni 7, pika 1, germa c), neni 32/1, germa a), si dhe neni 33, pikat 10, 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ministria e Brendshme, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit thelbësor të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes lidhur me ankesën e shtetasit Y.B, për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm për marrjen e një vendimi përfundimtar.
3. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA